

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Itali, 25-vjeçari shqiptar vritet nga pronari i banesës gjatë grabitjes
ADRESA	https://www.gazetatema.net/bota/itali-25-vjecari-shqiptar-vritet-nga-pronari-i-baneses-gjate-grabitjes-i587290
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	20 shtator 2026, 14:33:04 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	20 shtator 2026, 15:32:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	35604ec681097d344bbf899b505737d3046840c022d4edd2418d4aaf8bb6b368
TEKSTI	269774da1b267c2e09f2de920d16c823fd501c7a74c931d4f543240a8c74eb45
PAMJA	13c960c7674956042709a906fddb022ccecf91d969568a21e8746ca37fc58c6ae

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	5491c44fcb13e6e4a138dd0e402c6eeec1c80020be11121e773d4d29dbbd88a0
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/5491c44fcb13e6e4a138dd0e402c6eeec1c80020be11121e773d4d29dbbd88a0>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by

[Kontakt](#)

English

ie [Perfshihet nga liaket automjeti ne Gjirokastr, vetem deme materiale](#)[Kurti kerkon strategji shtetore pas verdiktit te Hages: 'Te mbeshtesim Apelin dhe te reagojme dipi](#)
fundit

Itali, 25-vjeçari shqiptar vritet nga pronari i banesës gjatë grabitjes

Tema

20 Shtator 2026, 17:32Bota TEMA



Një 25-vjeçar shqiptar, banues në Torino, është vrarë me armë zjarri në orët e para të mëngjesit të sotëm, teksa dyshohet se po grabiste një banesë në Baldissero d'Alba, në provincën e Cuneos, Itali.

Sipas mediave italiane, një grup prej të paktën 4-5 personash kishte hyrë në oborrin e banesës rreth orës 02:00 të mëngjesit, kur pronari, i identifikuar si Roberto Mollo, i ka zënë në befasi dhe ka qëlluar disa herë me pistoletën që e posedonte në mënyrë të ligjshme. Si pasojë, 25-vjeçari shqiptar ka mbetur i vdekur, ndërsa identiteti i tij nuk është bërë ende publik.

Sipas rindërtimit paraprak të ngjarjes, Mollo, një mekanik dhe shofer kamioni për transportin e kafshëve, ndodhej i vetëm në banesën në pronësi të prindërve të tij, kur dëgjoji zhurma nga jashtë.

Pasi dyshoi se në pronë kishin hyrë persona të paautorizuar, ai doli për të parë situatën dhe, kur u përball me grupin në errësirë, mori pistoletën gjysmëautomatike dhe hapi zjarr. Njëri prej personave mbeti i vrarë, ndërsa të tjerët u larguan nga vendngjarja. Ngjarja po hetohet nga autoritetet italiane për të sqaruar dinamikën e plotë të saj.



Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

[NATO mirëpret marrëveshjen për Groenlandën: SHBA pritet të zgjerojë praninë ushtarake në Arktik](#)

16:00 Bota

Italia goditet nga stuhi të fuqishme, lëshohet alarm për motin në 12 rajone

14:50 Bota

[Rregullat e reja, Italia drejt kufizimit të nxënësve të huaj në klasa! Meloni: Fëmijët italianë nuk mund të ndihen pakicë](#)

14:20 Bota / 18 komente

[Kim Jong-un kërkon më shumë armë me "inteligjencë artificiale", rritet prodhimi ushtarak në Korenë e Veriut](#)

14:10 Bota



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.